



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

00 Numër:187/2023
Data:21.11.2023



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>
Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG
Për: Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Në bazë të nenit 43 neni 45 dhe neni 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe nenit 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, neni 5 i Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

T H Ë R R A S

Mbledhjen e 21-të të rregullt të Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës.
Mbledhja do të mbahet më: **30.11.2023, e Enjte**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë në ora 10:00.

R E N D D I T E:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft- Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.
4. Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për caktimin e normave për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme private me numër të parcelave 00305-1, 00305-2, 00305-3, 00305-4, 00305-5 dhe këmbëhet me pronë publike P.SH. Rugët Publike me numër të parcelave P-70806057-00284-0.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për këmbimin e pronës private me numër të parcelave 00030-9 me parcelën 00031-3 pronë e Komunës së Istogut.
8. Vendim për Shfuqizimin e Vendimit 01.Nr.157/2019 i datës 26.12.2019.
9. Vendim për Shfuqizimin e Vendimit 01.Nr.156/2019 i datës 26.12.2019.
10. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

Vërejtje :

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në mbledhje,
t'i referoheni dispozitës së nenit 39 paragrafi 39.8 të LVL.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e njëzet e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **30.10.2023**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------------------|-----------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 15. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 16. <u>Negdet Ramaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 17. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 18. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 5. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 19. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 6. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 20. <u>Florian Maxharraj, VV;</u> |
| 7. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 21. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 8. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 22. <u>Arian Shatri VV;</u> |
| 9. <u>Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;</u> | 23. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 10. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 24. <u>Andi Xhuraj PDK;</u> |
| 11. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 25. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 12. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 26. <u>Melis Smakic;</u> |
| 13. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> | |
| 14. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, Nënkyetari i Komunës, z. Ali Nimanaj, nënkryetari për Komunitete z. Valmir Rama, Drejtoret e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, , monitoruesja nga DEMOS – KDI, OJQ “Toka” zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: “shembulli 1”)

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-te e xhirimit gjenden në dosje: “shembulli 2”).

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në <https://www.youtube.com/watch?v=C11WZgQflns>
<https://www.youtube.com/watch?v=JIdc538v6eY>

Procesverbali

<https://www.youtube.com/watch?v=pOyecjRYimk>
: “shembulli 3”).

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit– përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.

Hap punimet për mbledhjen e njëzet të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës në sallë, prezent janë 26 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R e n d d i t e

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e tretë (korrik-shtator) të vitit fiskal 2023,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Statutit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Istogut,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Istog (2024-2026),
6. Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024,
7. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit- pyes ekzekutivin dhe anëtarët e Kuvendit a kanë ndonjë vërejtje apo ndonjë pikë shtesë të rendit të ditës. Kryetari i komunës e ka fjalën.

Kryetari i komunës- përshëndet të gjithë të pranishmit! Ekzekutivi i ka dy pika jashtë rendit të ditës, sigurisht nëse e merr aprovimin nga Kuvendi, e para është Plotësim –Ndryshim i Vendimit për formimin e KKS-së dhe Aprovimi i Planit Komunal për Ri integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në komunën e Istogut.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit kryetar! Fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Desha ta bëj edhe njëherë pyetjen për ato dy pikat e muajit Prill, a kanë me ardhur ndonjëherë në diskutim ato? Në qoftë se nuk ju kujtohet është për pronat bujqësore, edhe për pasuritë e paluajtshme, banesat dhe lokalet afariste. Kanë qenë të planifikuara në muajin Prill, i keni anashkaluar z. kryesues, keni thënë në një mbledhje të radhës, ka pasur mbledhje që i kemi mbajtur vetëm me dy pika të rendit të ditës, nuk e di a e keni në plan ti sillni në Kuvend a jo. Edhe një kërkesë e pata, kolegu nuk ka mikrofon prej fillimit të mandatit dhe do kishte qenë mirë ta kishte. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- këto janë çështje teknike Florin, do të rregullohen me renovimin e sallës. Ne kemi biseduar shumë herë rreth asaj pike dhe tash ka ardhur koha që me i fut për të tretin vit, pronat janë me qindra hektarë, i kemi 24 prona bujqësore, ka prona që janë paraqitur për ankande publike ne bazë të interesit të bizneseve të qytetarëve dhe të fokus grupeve. E bëjmë edhe atë Florin, por këto çka janë me rend janë me rend, nëse ka diçka të keqe rreth atyre listave që janë paraqitur, nuk ka problem ja ku është ekzekutivi, kryetari i komunës, mund t'i jepni vërejtjet sugjerimet. Nuk di çfarë të them tjetër. Fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- këto kanë qenë me rend në muajin Prill, edhe unë mendoj që janë shumë të rëndësishme e jo që ne kemi diçka për të thënë, por do ishte dashur që dikush të raportoj për këto prona, me e ditur kush është duke i shfrytëzuar, çfarë po bëhet me to, edhe nuk e di arsyen pse nuk po guxoni t'i sillni, ose keni ndonjë interes të juaj personal ose është dikush që nuk po guxoni me i qit.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka kryetari i komunës.

Kryetari i komunës- Florin ne e vlerësojmë kur është koha me i qit e kur me raportuar, e kur është koha me i publikuar punët të cilat jemi duke i kryer. Edhe në lidhje me çështjen e pronave bujqësore, edhe me çështjen e lokaleve afariste e të banesave, të cilat nuk janë me dhjetëra siç po e thua ti, por janë numër jashtëzakonisht i vogël e që 99.99% prej tyre i shfrytëzojnë njerëz që janë të kategorive sociale, mirëpo e kuptoj këtë tendencën tënde politike me e bërë temë, nuk ka asgjë të keqe, fute në votim pikën që të kalon e futim në rend dite që jo nuk kemi çfarë të bëjmë.

Kryesuesi i Kuvendit- Florin janë 54 prona kanë dalë nëpër ankand, pse fokus grupet tjera që janë në ato prona pse nuk konkurrojnë, unë nuk e di pse dhe këtu ekzekutivi i ka duart e lidhura. Kryetari e ka fjalën.

Kryetari i komunës- në komunikim pothuajse të përditshëm me bujq dhe fermer komunën e Istogut e kanë qit si komunën e parë për prodhime që ata i sigurojnë përmes fermave në të cilat ata operojnë. Temë për neve janë kërkesat që ata i kanë parashtruar gojarisht gjatë diskutimeve që i kemi pasur edhe të cilat kanë me i proceduar brenda këtij muaji si kërkesa për marrje në shfrytëzim qoftë afatshkurtër qoftë afatgjatë të pronave komunale të cilat prona janë të klasave bujqësore. Çështja e 54 pronave është çështje që ne e kemi diskutuar këtu, e kemi aprovuar si listë që të publikohet për pronat me i dhënë në shfrytëzim, planifikojmë, nuk jemi ligjërisht të obliguar t'i japim, planifikojmë nëse ne shohim interes publik ashtu siç e parasheh ligji i japim, nëse nuk shohim interes publik vazhdojmë me e aprovuar si listë në vitin e ardhshëm normal nëse pajtoheni edhe ju, deri në momentin që arrijmë me e kapitalizuar si interes publik dhënien e asaj prone. Kaq.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj-

Florin Dreshaj- z. kryetar the që ne vendosim kur i qesim e çfarë bëjmë. Ajo ka qenë pikë e rendit të ditës, këtu është shkëlur Plani i Punës së Kuvendit, unë nuk e di pse bëhet Plani i Punës së Kuvendit, ku kryetari vendos a me i qit a jo. Edhe kryetari i komunës nuk vendos për Planin e Punës së Kuvendit, je kryetar edhe do muaj ndoshta mandej nuk je, ajo fare nuk ka rëndësi vjen dikush tjetër por për mua ato prona janë të uzurpuara, edhe bujqit që janë duke i shfrytëzuar, le t'i shfrytëzojnë edhe mandej, por shumë më mirë është me i qit do letra me i rregulluar në mënyrë të rregullt pastaj mund të përfitojnë edhe prej shteti subvencione, edhe

për ata është më mirë. për vete nuk kam asnjë lloj tendence, kam tokë mjaft ata nuk po mund të arrijë ta punoj. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- për ata nuk mund t'i kuptoj ata njerëz nuk mund t'i marrin subvencionet pa ardhur të konkurrojnë me dalë në ankand edhe me e kryer formalitetin. Ata uzurpatorë në një lloj mënyre po, por nuk vijnë me e legalizuar edhe me u bërë me të drejta të barabarta edhe obligimet me i kryer ndaj komunës. Po ja lëmë kohës atë. Unë e hedh në votim Plotësim -Ndryshimin e Vendimit për formimin e KKS-së, kush është që kjo pikë të hyn në rend dite?

Konstatojmë që nga 26 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në mënyrë unanime votohet që pika e propozuar nga ekzekutivi Plotësim -Ndryshim i Vendimit për formimin e KKS-së të futet në rendin e ditës.

E hedh në votim edhe pikën tjetër të propozuar nga ekzekutivi Planin Komunal për Ri integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në komunën e Istogut 2023-2025? Kush është për?

Konstatojmë që nga 26 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në mënyrë unanime votohet që pika e propozuar nga ekzekutivi Planin Komunal për Ri integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në komunën e Istogut 2023-2025? Kush është për?

Hedh në votim rendin e ditës në tërësi, kush është për?

Konstatojmë që nga 26 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në mënyrë unanime miratohet rendi ditës për mbledhjen e sotme.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- në bazë të listës së nënshkrimeve të pranishëm janë 26 anëtarë të Kuvendit dhe mungon Arianit Selmanaj i cili ka lajmëruar që për shkaqe shëndetësore nuk ka pasur mundësi të jetë i pranishëm.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit- i kemi dy procesverbale nga mbledhja e rregullt e datës 25.09.2023 dhe e mbledhjes së jashtëzakonshme të datës 02.10.2023, a ka ndonjë vërejtje, sugjerim? Konstatojmë që nuk ka. E hedh në votim, kush është që të miratohen procesverbalet nga mbledhjet e kaluara?

Konstatojmë që nga 26 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në mënyrë unanime miratohen procesverbalet nga mbledhja e rregullt e datës 25.09.2023 dhe e mbledhjes së jashtëzakonshme të datës 02.10.2023.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit- i nderuar kryetar e keni fjalën.

Kryetari i komunës- fton zyrtarin kryesor financiar Osman Sadikaj.

Osman Sadikaj- përshëndet të gjithë të pranishmit dhe prezanton raportin financiar për tre mujorin e tretë (korrik-shtator) të vitit fiskal 2023.

Kryesuesi i Kuvendit – faleminderit Osman! Hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, a e dëshiron dikush fjalën? Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Sa i përket këtij raporti i kam ngritur disa shqetësime p.sh te numri i punëtorëve është shqetësuese mos kompletimi i njësisë së Auditimit të brendshëm, pra kjo është një e gjetur e përsëritshme në raportin e Auditorit , ne e shohim prapë që nuk është funksionale duhet të jenë dy punëtorë sipas ndarjeve buxhetore të vitit 2023 e si vende të lira figurojnë që janë dy, mirëpo te raporti përmbledhës prapë shkruan se janë alokuar mjetet, është problem që na përcjell çdo vit dhe po i kushton komunës me pikë minus në grantin e performancës. Ndërsa tek analiza e këtij raporti në bazë të ndarjeve në kategoritë ekonomike vazhdon ecuria e ngadaltë e përqindjeve në raport me alokimet ku kanë mbetur edhe tre muaj në përfundim të vitit, komuna ka shpenzuar vetëm 21.66% të buxhetit në investime kapitale. Kështu duke rrezikuar që një pjesë e mjeteve të kalojnë në suficit. Mos të harrojmë që vitin e kaluar si pasojë e paaftësisë së ekzekutivit komunal kemi pasur suficit në investime një milionë euro. Pra në këta terma i bie që kryetari aktual është duke përfomuar edhe më dobët se kryetarët paraprak, mirëpo kjo përqindje e ulët nuk ndodhë edhe te pagat dhe mëditjet pasi që ato e kanë tejkaluar edhe planifikimin janë 101.63%. Ne po shpresojmë që në raportin e radhës TM4 të këtë një përqindje sa më të vogël të suficitit dhe të këtë shifra më të arsyeshme për shkak se kanë mbetur vetëm edhe tre muaj, dhe ka mundësi që suficitit të jetë skandal sikurse vitin e kaluar. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Osman Sadikaj.

Osman Sadikaj- sqaron dhe përgjigjet në pyetjet e Niman Beqiraj.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj-tek numri i punëtorëve sipas Ligjit për ndarjet buxhetore aty i kemi paraparë dy për Auditim thashë janë dy të lira por prapë në bazë të Ligjit si e kam lexuar aty duhet të jenë tre, pra edhe planifikimi nuk është bërë mirë, se mbi shtatë milionë euro nëse ka një institucion buxhet atëherë kalohet prej dy në tre. Faleminderit!

Osman Sadikaj- sipas Ligjit, dhe në bazë të totalit të buxhetit ti ke të drejtë që duhet me qenë një udhëheqës i Zyrës së Auditimit dhe dy auditorë. Por ne edhe pse i kemi qit dy, nuk kemi pasur shans t'i plotësojmë për shkak të certifikimit, nuk është çështje problem me ndarjet buxhetore, se neve si komunë gjatë vitit fiskal askush nuk na ndalon, nëse një program buxhetor mendojmë se i kemi të planifikuar tepër, me një ridestitim për një vendim të Kuvendit mundemi ta rritim në cilin do numër. Problem ka qenë se ne nuk po kemi mundësi t'i certifikojmë auditorët. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Osman! A dëshiron edhe dikush fjalën? Po konstatojmë që jo.

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka kryetari i komunës.

Kryetari i komunës -ja kalon fjalën drejtoreshës Merita Bytyçi.

Merita Bytyçi- përshëndet të gjithë të pranishmit dhe prezanton Draft-Statutit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Istogut.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtoreshë! Hapi debatin rreth kësaj pike? Fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- përshëndet të gjithë të pranishmit! E kam parë këtë Draft-Statut është e hartuar shumë mirë, edhe e kisha një pyetje rreth Qendrës Sociale, aty përveç këtij Statuti është një çështje që rregullohet me krijimin e organit të kujdestarisë, dhe në bazë të informatave që i kam aty nuk po mund të formohet një organ i kujdestarisë i cili duhet me qenë prej pesë personave, aty janë vetëm tre persona, dhe në këtë moment kjo Qendër po punon jashtëligjshëm në raste të caktuara sepse pa organ të kujdestarisë aty duhet të mblidhen një jurist, një psikolog drejtori i Qendrës dhe punëtorë që merren me këto punë, sepse ne e dimë që aty ka raste të ndjeshme, si problemet familjare, apo me fëmijë, dhe ata po e kryen punën jashtëligjshëm faktikisht. Nuk ka psikolog në atë Qendër, kryesisht merren psikolog të jashtëm që nuk janë të licencuar për atë punë, dhe aty ka raste të trajtimit të veçanta. Përveç këtij Statuti, kam dëshirë ta di nga drejtoresha si po funksionon pa organ të kujdestarisë pa psikolog edhe këto probleme tjera që po thuhet që po punohet jashtëligjshëm në raste të caktuara. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Agron! Drejtoreshë fjala është për ju.

Merita Bytyçi- faleminderit për pyetje! Ne organin e kujdestarisë e kemi funksional, edhe së fundmi e kemi pasur një diskutim edhe me avokatin e popullit, përveçse psikologe që nuk kemi në Qendër për Punë Sociale, psikologia është në fazat e rekrutimit edhe konkursi ka përfunduar. Sa i përket psikologëve gjithmonë e kemi gjetur gatishmërinë prej drejtorisë së Arsimit në moment që kemi pasur nevojë për psikologe. Ti e përmende se janë vetëm tre, unë po të tregoj se janë katër që e bëjnë organin e kujdestarisë me qenë funksional dhe tani i bashkëngjitet edhe psikologia, kështu që organi i kujdestarisë është funksional, nuk besoj që është i jashtëligjshëm, sepse janë katër zyrtarë dhe tani bëhen pesë.

Kryesuesi i Kuvendit- urdhëro Agron si replikë.

Agron Gashi- unë e potencova që në bazë të ligjit që pesë anëtarë duhet të jenë që të krijohet organi i kujdestarisë, sepse ti mundesh me e formuar edhe me një po në bazë të ligjit është me pesë. Deri tani kanë qenë tre, me këtë tani bëhen katër, por pesë nuk kanë qenë deri tani. Ata kanë punuar deri tani por jashtëligjshëm. Faleminderit!

Merita Bytyçi- ashtu siç e potencova më herët, nuk janë tre por janë katër, në kuadër të saj përfshihet edhe juristja, besoj kishte me qenë më mirë me marrë informata adekuate, pra kemi edhe juriste që hyn në kuadër të organit të kujdestarisë. Sa i përket psikologëve jo vetëm në komunën e Istogut por edhe brenda gjithë territorit administrativ të Kosovës kanë problem Qendrat për Punë Sociale me psikolog, e ceka edhe më herët jemi në faza të rekrutimit dhe shpejt do të zgjidhet ky problem në komunën tonë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Lavdije Bujupaj.

Lavdije Bujupaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Para vetes kemi Draft-Statutin e Qendrës për Punë Sociale një projekt i rregulluar mirë që sot pritet të miratohet në Kuvend, mirëpo para se të miratohet i drejtohem drejtorisë së Mirëqenies Sociale me disa kërkesa për ndryshim çdoherë lidhur me të mirën e organizatës në fjalë. Propozoj që numri i punëtorëve në Qendrën për Punë Sociale nuk është i mjaftueshëm pra të rritet numri i punëtorëve në të ardhmen, në mënyrë që puna të jetë më efikase. Lidhur me kujdestarinë propozoj që numri i punëtorëve nga tre të kalohet në pesë. Rekomandimi i tretë është që viktimave të dhunës në familje të ju jepet një përkrahje rreth punësimit në Qendrën për Punë Sociale, sa e di unë deri me tani nuk ka ndodhur dhe shpresoj shumë që në të ardhmen kësaj kategorie ti jepet një rëndësi e veçantë dhe e katërta është të formohen organizata joqeveritare në mënyrë që Qendra për Punë Sociale të blej shërbime duke e ditur që numri i të moshuarave është në rritje dhe kanë nevojë për strehim përkujdesje e me radhë. Dhe krejt në fund nëse këtij Draft-Statuti ja shtojmë këto kritere të cekura më lartë besoj që do kishim dalë mirë si komunë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtoresha!

Merita Bytyçi- e përmende për viktimat e dhunës në familje, këto raste janë që ne vazhdimisht i subvencionojmë me pagesa të qirasë, ka raste prej tyre që nuk kanë nga të ja mbajnë, dhe ne si drejtori po ju dalim në ndihmë qoftë me subvencionim të qirasë apo me përkrahje të tjera financiare. Organizata për strehim për personat e moshuar që e përmende ne nuk jem kompetente me formuar organizatë joqeveritare. Qendra për Punë Sociale është institucion publik profesional e jo organizatë. Sa i përket strehimit të personave të moshuar, vet Qendra Për Punë Sociale përgatit raportin prej momentit të strehimit për rezidentë, që në bazë të kritereve i pranojmë në Shtëpinë e Komuniteteve në Gurakoc, pra jemi kompetent vetëm në përgatitjen e dokumentacionit për strehim Shtëpinë e Komuniteteve në Gurakoc. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Lavdije Bujupaj si replikë.

Lavdije Bujupaj- drejtoreshë, po më duket që nuk më kuptuat mirë, nuk thashë që Qendra për Punë Sociale nuk e përkrah këtë kategori të ndjeshme, i di përparësitë dhe mundësitë që ja u ofroni, mirëpo e ceka që kishte me qenë mirë që në të ardhmen me ju jap rreth punësimit në Qendrën për Punë Sociale, aty e pata fjalën. Kaq.

Merita Bytyçi- Qendra për Punë Sociale e ka edhe numrin e limituar sa i përket punësimit, dhe çdoherë që kemi vende të lira mundohem me i plotësuar ato vende të lira.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit! Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Rreth Qendrës për Punë Sociale dhe këtij Draft-Statuti është bërë një punë e mirë në këtë drejtim, mirëpo edhe përkundër që është bërë punë e mirë ndoshta ka hapësirë diku ndonjë vend të plotësohet. E kisha një pyetje për rezidentët në Gurakoc a mjafton kapaciteti i objektit ekzistues për strehimin e atyre rezidentëve, e nëse jo atëherë a ka mundësi të zgjerohet kjo qendër marrë parasysh që në afërsi ndodhet një objekt i vjetër që ndoshta është pronë komunale dhe mund të rrënohet.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit! Urdhëro drejtoreshë!

Merita Bytyçi-për momentin kemi kapacitet të mjaftueshëm, aktualisht i kemi 17 rezidentë në Shtëpinë e Komuniteteve në Gurrakoc, ndërsa kapaciteti i përgjithshëm është për 20 rezident. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtoreshë! Fjalën e ka kryetari i komunës.

Kryetari i komunës- një gjë duhet ta kemi parasysh që, menaxhimi i Shtëpinë e Komuniteteve në Gurrakoc është kompetencë e përzier mes neve dhe ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ofrojmë shërbim jo vetëm për qytetarët e komunës së Istogut por pothuajse për gjithë Rrafshin e Dukagjinit nëse nuk jam gabim. Sigurisht që ne kemi hapësira të mjaftueshme se ku mundem me ndërtuar objekte që ndoshta munden me i plotësuar kushtet edhe më mirë se sa i plotëson objekti që është tani, por është çështje e kompetencave, duhet vullnet i dyanshëm jo vetëm nga ne në mënyrë që me e filluar si proces se pajtohemi ndoshta kishte me qenë mirë me e pas një objekt më të madh një objekt që edhe pse në brendësinë e tij i plotëson kushtet jashtëzakonisht mirë. I ka tejkaluar shërbimet në krahasim me këta privat që ofrojnë të njëjtat shërbime përkundër që këtu nga pagesa që e bëjnë janë të liruar një pjesë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- a dëshiron edhe dikush fjalën? Po duket që jo, e hedh në votim kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës?

Konstatohet që nga 25 anëtarë të pranishëm të Kuvendit në mënyrë unanime miratohet Draft-Statutit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Istogut.

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi Kuvendit- kryetar fjala është për ju.
Kryetari i komunës ja kalon fjalën drejtoreshës Merita Bytyçi.

Merita Bytyçi- prezanton Planin e Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Istog (2024-2026).

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtoreshë! Hapi debatin rreth kësaj pike. Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- desha me pyet drejtoreshën a është i formuar Kuvendi i fëmijëve, a është paraparë që për fëmijët të ketë ndonjë buxhet të veçantë, dhe për të gjitha këto fusha të cilat janë të një rëndësie të veçantë, por unë kisha dashur t'i përkushtohem hapësirave të sigurisë për fëmijët, përkundër të drejtave të fëmijëve që kanë për rritje, zhvillim për ofrime të shërbimeve shëndetësore, për arsimim, njëkohësisht të një rëndësie të veçantë e kisha pas fushën për sigurimin e fëmijëve respektivisht fushën e hapësirave të sigurisë për fëmijët pikërisht me një theks të veçantë përreth shkollave marrë parasysh se aty thuhet se të mbrohen fëmijët nga rreziqet e ndryshme në mesin e tyre që e kam potencuar edhe në KPF është abuzimi i mënyrave të ndryshme të fëmijëve, këtu ju e keni përmend pikën 3.2 për me i evituar rreziqet, promovimi i linjave të ndryshme telefonike, pra për raportim para se të ndodhin rreziqet, si do ta realizoni këtë, a keni marrë ndonjë model diku apo jeni vet për herë të parë që do ta bëni këtë dhe si do ta bëni? Po në këtë pikë 3.2 është parandalimi i rreziqeve përreth hapësirave shkollore me një pikë synim shitjen e artikujve të ndryshme që paraqesin rrezik për fëmijët nga

personat e paautorizuar që i ofrohen këtyre objekteve shkollore, si e parashihni ju këtë ndalim të këtyre rreziqeve të listuara? Faleminderit!

Merita Bytyçi- Kuvendi i fëmijëve ka qenë por për momentin nuk është aktiv, kështu që parashihet që shumë shpejt të riaktivizohet. Sa i përket buxhetit, për aktivitetet që i kemi paraparë në këtë plan besoj materialin e keni marrë por pak me vonesë, ku aty parashihen aktivitetet që ne i kemi planifikuar gjatë këtij mandati tre vjeçar të këtij ekipi, për një aktivitet të caktuar parashihet një buxhet dhe nga do të sigurohet ai buxhet qoftë prej niveli komunal, në bashkëpunim me organizata të ndryshme. Sa i përket abuzimit të fëmijëve e kam përmendur edhe në KPF që të gjitha fushat e veprimit apo objektivat janë të ndërlidhura njëra me tjetrën, ku vet na sjellin përmes fushatave të vetëdijesimit apo aktiviteteve të ndryshme që e bëjnë këtë plan më gjithëpërfshirës duke kontribuar që të ndalohet abuzimi qoftë në shkolla apo në institucione tjera. E përmende telefono psikologun, tash vonë është krijuar një telefonatë pa pagesë “Telefono psikologun” në bashkëpunim kryetari i komunës me drejtorinë e Shëndetësisë dhe rininë ku kanë lansuar një rrjet telefonik ku gjithsecili ka mundësi për probleme të ndryshme ta telefonoj psikologun dhe ta adresojnë kërkesën e tyre ku linja telefonike është pa pagesë. Sa i përket hapësirave shkollore drejtoria e Arsimit ka planifikuar një sërë aktivitetesh për parandalimin e këtyre dukurive negative qoftë shitja e narkotikëve abuzimet me alkool që po ndodhin, të cilat do mundohemi edhe përmes mediave t’i parandalojmë këto dukuri. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- Ajshe Metaj replikë.

Ajshe Metaj- unë vetëm thashë se si fëmija mundet me qenë i sigurt, p.sh. me i siguruar hapësirat e jashtme të shkollave sidomos për moshat e ndjeshme, ku me ata fëmijë mundet të abuzojë kushdo. Ju e thatë në fushën e arsimit edhe fushatat e vetëdijesimit edhe ne në shkollë përpiqemi që me plan programin, ku paguhet edhe trajnime të ndryshme, por te fëmijët e moshave të ndjeshme nuk ka shumë efekt, çka kërkohet pak më tepër që me u mbrojtur edhe ata fëmijë. P.sh. si mund të ndihem unë e sigurt nëse e dërgoj një fëmijë 10 vjeç në shkollën fillore në “Bajram Curri”? Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka kryetari.

Kryetari i komunës- miratimi i Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, çka po diskutoni ju janë çështje bien komplet në punën, funksionin, kompetencat, obligimet dhe përgjegjësitë e drejtorisë së Arsimit. Gjatë diskutimit të juaj janë dhjetëra masa që i kemi ndërmarrë bashkërisht me drejtorinë e Arsimit, drejtorinë e Shëndetësisë për fushën e vet dhe drejtorinë për Mirëqenie Sociale, e çka është më kryesore me Policinë e Kosovës për fushën e vet që është organi kryesor që ofron siguri në afërsi të shkollave. Ka plan operativ të cilët operojnë në afërsi të shkollave qoftë me persona me uniformë qoftë pa uniformë në vendet ku ata parashohin që ka nevojë për hetim ose jo. Rrezikshmëria në raport me abuzim me materie narkotike apo forma tjera të te rinjve, është një fushatë që është ndërmarr edhe prej drejtorisë së Inspektionit bashkë me inspektorët e tregut në mënyrë që me i eliminuar ato produkte, ose me e vështirësuar qasjen e tyre në ato produkte. Jo rastësisht e përmende shkollën fillore “Bajram Curri” jemi të vetëdijshëm ju e ceket një shkollë që ka 1000 nxënës sigurisht edhe problemet kanë me qenë më të mëdha. Është shkollë që është në monitorim ka vizita mos të them ditore edhe prej drejtorit edhe prej hetuesve policorë që merren me hetimin e dukurive negative. Besoj që është duke u bërë më e mira e mundshme me i parandaluar këto dukuri të këqija sidomos te shkolla fillore.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit kryetar për ekzaminimin. A e dëshiron dikush tjetër fjalën. Hajrush Shoshi është lajmëruar.

Hajrush Shoshi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Kur flasim për fëmijët unë besoj do ishte dashur të ishim shumë më të kujdesshëm gjatë fjalimeve sepse jemi para një audience edhe t'i tregojmë faktet e sakta, jo paushallë të nivelit komunal. Është mirë edhe Inspekcioni të punojnë në drejtimin sepse është Ligji që e përcakton qartë se cilat mjete duhet të shiten afër shkollave deri në 500 m janë të kufizuara edhe cigaret edhe alkooli, por kur po flasim për drogën më besoni po shqetësohem shumë, nuk e di si flasim aq lirshëm kur nuk e kemi ndonjë argument, duhet të kemi argumente. Kërkoj nga drejtorja e Arsimit t'i zbatoj këto rregulla, nuk besoj që ka raste të shumta ashtu siç po paraqiten, nuk kemi. Nuk e di sa raste abuzive i ka drejtori të paraqitura, kishte me qenë mirë me na dhënë një informatë gjatë vitit shkollor, sepse ato raste së pari lajmërohen te drejtori te policia, të jemi më të informuar. Për mua është një Plan shumë ambicioz, kisha pasur dëshirë të realizohet, është i punuar mirë, dhe vetëm ju dëshiroj suksese.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- mënyrën si po i paraqet kolegu duhet me e ditur që nuk jam një person që bëj pyetje paushallë, se nuk jam as në jetë paushallë po jam me koncepte të caktuara, edhe ky ka qenë drejtor edhe e di që këto gjera kanë qenë aktuale, e di edhe sa masa janë shqiptuar, i dimë të gjitha se si janë abuzuar të moshave të reja, unë e bëra një lloj krahasimi, nuk është paushallë, situata është problematike mjaftueshëm. Neve na u tha që do të ketë masa të sigurisë por p.sh unë problemin më të madh e kam me moshat më të reja, po vijnë fëmijët e infektuar me narkotikë ne jemi ata që duhet të merremi me ta, shkolla siguria. Kolegun e përshëndes, për mënyrë paushallë ndoshta e ka ndonjë adresë tjetër, dhe te unë kurrë mos të adresohet më, me keqardhjen më të madhe. I kam faktet punoj aty që gati 40 vite, por problemet po shtohen në fazën e tranzicionit këtë e dimë të gjithë. A janë alarmante a nuk janë statistikave i ka drejtori. Por edhe ne i kemi edhe i përcjellim gjërat siç shkojnë. Duhet të mobilizohemi të gjithë që fëmijët mos të infektohen ky ishte mesazhi im.

Kryesuesi i Kuvendit- Hajrush Shoshi si replikë.

Hajrush Shoshi- edhe unë isha bukur i qartë, i kemi rreth 6400 nxënës në nivel komunal, besoj që është numri shumë minimal që ka abuzime apo probleme, mirëpo po i frikësojmë ndoshta prindërit si t'i dërgojmë fëmijët në këto shkolla. Mos ta bëjmë aq alarmante, është duke u punuar, probleme ka në çdo shkollë, dhe nuk do të ndalen kurrë. Gjendja në arsim nuk është aq kritike sa po paraqitet.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka kërkuar Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- faleminderit kryesues! Unë së pari e pata një vërejtje për ty, dikujt po ja kufizon kohën kur po flet për rend dite e dikujt po ja jep fjalën jashtë rendit të ditës. Unë vetëm desha ta mbështes Ajshen ne punojmë bashkë aty edhe kemi plotë raste, edhe nuk është jo alarmante kur arrestohen e burgosen nxënësit për ato probleme për narkotikë e këto gjëra, nuk e di se ku do shkoj më alarmante, edhe ne edhe policia jemi duke e bërë punën tonë, por nuk është që po mjafton, duhet të mundohemi sa më shumë. Shqetësimi i Ajshes ishte shumë i drejtë, kolegu Hajrush i nuk ishte dashur t'i thoshte paushallë me pas pak konsideratë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- unë jam shumë korrekt me juve dhe me vetën. A e dëshiron edhe dikush fjalën? Po konsideroj që jo. E hedh në votim, kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës?

Konstatojmë që nga 21 anëtarë të pranishëm të Kuvendit në mënyrë unanime miratohet Plani i Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Istog (2024-2026).

Shqyrtimi pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit- materialin e keni marrë. Është obligative që të formohet ky grup punues për hartimin e Planit Punues, i lus partitë politike që ta dërgojnë nga një përfaqësues. Të gjitha partitë që marrin pjesë në Kuvend e kanë nga një përfaqësues, sekretaria e Kuvendit merr pjesë gjithashtu. Florin Dreshaj e ka kërkuar fjalën.

Florin Dreshaj- ne si Lëvizje Vetëvendosje kemi dilema a ja vlen me e dërguar një anëtar tonin në këtë grup punues me dhënë kontributin këtu, pasi që nuk po e respektoni Planin e Punës që po hartohet nga ai grup punues dhe po miratohet në këtë Kuvend kryesues. Në qoftë se na premtan para qytetarëve që e respekton atë Plan të Punës ne e dërgojmë përfaqësuesin nga partia jonë, nëse jo atëherë nuk e dërgojmë kot.

Kryesuesi i Kuvendit- unë një herë jam betuar këtu dy herë nuk betohem. Nëse nuk doni ta dërgoni mos e dërgoni. Unë e thashë profilin që duhet ta ketë përbërja nga të gjitha partitë, por nëse dëshironi mos e dërgoni.

Florin Dreshaj- nuk thashë që nuk duam, por nëse ju nuk e respektoni atë Plan të Punës a ja vlen me e dërguar a nuk ja vlen. Ju po na pamundësoni me e dërguar dikë me e dhënë kontributin e vet. Ne duam se e kemi marrë votën e qytetarëve e kemi obligim, po nëse ju nuk e respektoni sa ka vlerë me e dërguar. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- grupi duhet të formohet prej pesë ose shtatë anëtarëve, unë propozoj që të jenë shtatë anëtarë. Pesë nga partitë politike, një nga sekretaria e Kuvendit dhe zyra ligjore. Kisha kërkuar nga partitë politike që ta caktojnë nga një përfaqësues. Nëse i keni emrat këtu propozoni. Agron Gashi e ka fjalën.

Agron Gashi- Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës propozon z. Negjdet Ramaj.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit shumë! Niman Beqiraj e ka kërkuar fjalën.

Niman Beqiraj- ne ja u dërgojmë emrin sekretarisë së Kuvendit më vonë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Haki Podrimaj.

Haki Podrimaj- nga Lidhja Demokratike e Kosovës propozojmë znj. Arta Balaj.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit shumë! Era Visoqi e ka fjalën.

Era Visoqi- ne nga Partia Demokratike e Kosovës propozojmë Andi Xhuraj.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit shumë! Na mbetet edhe Melisi që do të jetë si pjesë përbërëse e grupit punues. Ju falënderoj shumë! Kush është që të jetë kjo përbërje nga pesë përfaqësuesit e partive politike një nga sekretaria e Kuvendit dhe drejtori i drejtorisë së Administratës. E hedh në votim kush është për?

Konstatojmë që nga 22 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota për 0 kundër dhe 5 abstenime miratohet Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka kryetari i komunës.

Kryetari i komunës-faleminderit kryesues, ashtu siç e ceka edhe në propozim është çështje teknike plotësim ndryshimi i emrave, po vazhdoj me emrat, Servete Bujupaj, zyrtare për barazi gjinore ndërrohet në Servete Haxhijaj, Robert Gegaj kryesues i këshillit të prindërve në komunë, tash është zgjedhur Enver Balaj kryesues i ri i këshillit të prindërve në komunë, Xhevair Hasanaj toger i FSK-së me kërkesë të FSK-së tani emërohet nën toger Albestrin Rexhepi, dhe nga shoqeria civile nga Asdren Hasanaj që ka qenë pjestar i OJQ-se "Liria" kalojmë në KVRL me propozim të Blendor Isufaj.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit kryetar! Fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- ne e kemi pasur pjesë përbërse edhe Burgun e Dubravës edhe aty ka pasur ndryshime nuk është më drejtori që ka qenë ndoshta edhe aty duhet të bëhet një ndryshim.

Kryesuesi i Kuvendit- sa për informim Niman, institucionet e sigurisë të Republikës së Kosovës siç janë FSK-ja Policia, burgjet apo institucionet tjera relevante i dërgojnë të përfaqësuar si në aspektet ceremoniale, apo zyrtare që kanë karakter pune, i dërgojnë njerëzit që janë adekuat për atë punë ose mbledhje. Dikush tjetër a e dëshiron fjalën? Konstatojmë që jo. Hedh në votim, kush është për që të miratohet ky plotësim ndryshim i vendimit të KKSB-së?

Konstatojmë që nga 21 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në mënyrë unanime miratohet Plotësim-Ndryshimi i Vendimit të KKSB-së.

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i Kuvendit- materialin e keni marrë me vonesë e tregoi edhe kryetari si dhe pse, nuk është çështje që varet nga zyra komunale për komunitete dhe kthim, kështu që afati kohor na duhet kështu që ju kisha kërkuar mirëkuptim sepse është çështje e performancës së komunës, kështu që ju kisha kërkuar prapë mirëkuptim se materiali ka qenë vulominoz dhe ndoshta nuk keni munduar ta shtjelloni, dhe e hapi debatin rreth kësaj pike. Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- faleminderit kryesues! Lëvizja Vetëvendosje nuk mundet të jep kontribut në këtë pikë, jo pak po nuk kemi mundur ta shtjellojmë fare materialin për shkak të asaj që kërkohe mirëkuptim ne abstenojmë nuk jemi kundër, nuk e dimë se çfarë ka në material, nuk mund ta jepim kontributin tonë ndonjë sugjerim apo vërejtje.

Kryesuesi i Kuvendit- të kishin qenë pika që duhet të kalojnë patjetër në Komitetin për Politikë dhe Financa nuk i kishim sjellë në rend dite as këtë as pikën para kësaj. Në rregull. A dëshiron edhe dikush tjetër të diskutojë rreth kësaj pike? Po konsideroj që jo. E hedh në votim, kush është që kjo pikë të miratohet?

Konstatohet që nga 22 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota për 0 kundër dhe 4 abstenime miratohet Plan Komunal për Ri integrim të Qëndrushëm të Personave të Ri atdhesuar dhe Integrimin e të huajve në komunën e Istogut 2023-2025.

Shqyrtimi i pikes 9.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- meqë anëtari i Kuvendit është i thirrur që ti adresoj kërkesat e qytetarëve në Kuvend, dhe ekzekutivi me ju përgjigj në bazë të afateve ligjore unë i kam bërë disa pyetje në mbledhjen e 31 gushtit, dhe kryetari më ka thënë që do t'i keni përgjigjet në afat ligjor. Sot është dita e 60 dhe unë ende nuk i kam atë përgjigje. Mua më vjen keq për mospërfilljen e kryetarit të komunës karshi Kuvendit dhe mos respektimin e afateve. Me qenë arrogant në Istog nuk të bën nder as ty as Kuvendit. Për këtë mbledhje unë i kam këto pyetje. Pyetja parë ka të bëjë me Shëndetësinë, kërkesa e shumë qytetarëve që nuk mund të pajisen në QKMF me certifikatën për punësim, që tregon që është i aftë për punë, dhe të njëjtit brenda QKMF-së informohen se këtë mund ta bëjnë privat e cila kushton 15 euro. Si qëndron puna, a mund të jepen këto edhe në QKMF-të ku do të kushtonte më lirë dhe nuk do të ishte barrë për qytetarët. Pyetja e dytë ka të bëjë me banorët e fshatit Dubravë, që përdorin rrugën "Mehmet Ujupi" dhe janë diku rreth 30 shtëpi, kanë kërkuar që të asfaltohet kjo rrugë sepse është në gjendje të keqe. Pyetja e tretë është për ekzekutivin, është rasti të shikolla fillore në Vrellë, "Hysni Zajmi" është fjala për policinë e shtrirë, është një pengesë rrugore, që do të duhet të ndihmonte në sigurinë e nxënësve nga shpejtësia, mirëpo ajo nuk është vendosur komplet, kështu që është kthyer në një rrezik për nxënësit, sepse te pjesa e parkingut, nuk mbulohet nga polici i shtrirë dhe kalojnë me shpejtësi në atë pjesë, ky problem është paksa edhe më shumë kompleks sepse në vendin e njëjtë në anën tjetër të rrugës janë vendosur disa sfera të betonit përballë ish kompanisë "Teuta" në trotuar. Pra ku ka pasur edhe pasoja sepse në njërin sferë të betonit është aksidentuar edhe një fëmijë ku ka pasur pasoja ku e kemi parë edhe videon. Kërkojmë të bëhet një zgjidhje ose të largohen sferat e betonit nga trotuari, ose le të largohen zebat, sepse më nuk ka kuptim dhe po i hutojnë qytetarët. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- si Kuvend, ja ku është edhe monitoruesja, jemi shembull për punën për qasjen për kolegialitetin në Kosovë. Ta ruajmë qasjen e shprehjes, mos të dalim jashtë asaj që e meriton ky Kuvend. Fjalën e ka drejtori Zenel Shatri.

Zenel Shatri- përshëndet të gjithë të pranishmit! Niman nuk e kuptova pyetjen, certifikatën shëndetësore për punësim, apo certifikatën mjekësore për patentë shofer ose

për pajisje me armë. Sa i përket certifikatës shëndetësore për punësim nxirret në QKMF, ndërsa ato dyja që i përmenda më lartën nuk nxirren sepse nuk i kem profilet, nuk jemi të autorizuar.

Niman Beqiraj- faleminderit për përgjigje, mirëpo ne i kemi disa raste që ju kanë thënë shkoni privat sepse ne nuk japim certifikatën shëndetësore për punësim. Pyetja është a japin?

Zenel Shatri- i japin. Certifikatat shëndetësore për punësim çdoherë janë dhënë. Nuk besoj që janë kthyer qytetarët për certifikatat shëndetësore për punësim. E për ato dy tjerat për patentë shofer dhe pajisje me armë po. Ndoshta mjeku ja kërkon ndonjë analizë për çështjen shëndetësore por ato jepen.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Abedin Kabashi.

Abedin Kabashi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Niman pyetjen e ke bërë para dy muajve për ulëset në park të Vrellës dhe realisht ta kam dhënë përgjigjen të kam thënë që drejtorja e Arsimit e ka një projekt që ka me i furnizuar shkollat me ulëse dhe kontejner , dhe në moment që fillon kontrata të implementohet ne kemi me i kryer ato.

Niman Beqiraj- pyetjet kanë qenë të seancës së 31 gushtit, ndriçimi publik i vendosur mbi murin e xhamisë të rruga “Feriz Blakaj” një ndriçim prej 50 m. Është i lidhur për murin e xhamisë dhe është bërë barrë e rëndë për xhaminë, si qëndron puna dhe a është e mundur, të kalohet kjo me pagesë nga komuna ka qenë si pyetje? Tjetra ka qenë për rojet që kanë punuar të shtëpia e kulturës në Istog e që nuk i kanë marrë rrogat afër 6 muaj, këto janë në procesverbale, ka mundur ti shikoj kryetari dhe tu përgjigjet me kohë, dhe pyetja tretë ka qenë për murin, për rrethojat e xhamisë në Istog të cilat pasi janë hequr që kanë qenë donacion janë vendosur prapë pastaj me mjete të komunës. Faleminderit!

Abedin Kabashi- lidhur me pyetjen që e bëre, për pengat që janë përballë shkollës, unë vet kam qenë prezent aty ku i kemi vendosur policët e shtrirë dhe në konsultim edhe me drejtorinë shkollës, është vendosur që të ajo pjesë mos të vendosen policët e shtrirë, për arsye se ajo pjesë përdoret për parking. Edhe në bazë të zyrtarit për komunikacion ajo pjesë ka mbetur ashtu edhe për të mirën që ata punëtorë të arsimit apo qytetarët e ndryshëm në ditë të tjera ta shfrytëzojnë atë pjesë për parking. Niman ne mund ti diskutojmë këto punë edhe në vend të ngjarjes direkt, unë jam i hapur për të gjithë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi-

Agron Gashi- kisha një pyetje për drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, e kemi votuar një rregullore për shfrytëzimin e hapësirave të ndryshme që i përkasin kësaj drejtorie edhe për parkingje, desha një përgjigje nga drejtorja se sa po ecet me këtë rregullore, a është hapur ndonjë tender që munden njerëzit me i marrë këto, sa ka të interesuar, unë vet kam pasur pyetje për një parking të caktuar, sepse kjo rregullore është kryer, edhe e mira e asaj është që ato mund të mirëmbahen po ashtu të jepen fonde komunës, sepse disa parkingje po shkatërrohen. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- edhe pak e ke përgjigjen. Fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- faleminderit! Unë kam një pyetje për drejtorin e Arsimit, çfarë ndodhi me çerdhen që ishte te një objekt i vjetër I shkollës këtu “Bajram Curri” pranë policisë, si qëndron situata, aty po më duket që nuk po ec puna, po pyesin qytetarët, marrë parasysh që kanë nevoja të mëdha për inkuadrimin e femijëve në çerdhe, a po vazhdon puna apo si qëndron?

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Floriana Maxharraj.

Floriana Maxharraj-përshëndet të gjithë të pranishmit! Duke e ditur rëndësinë dhe sa krenar po na bën hendbolli si komunë dhe si shtet, një nga ekipet më të mira në Ballkan, besoj që mungesa e fondeve për t'i zhvilluar ndeshjet jashtë vendit nuk do duhej të ishte brengë për ta, brengë e vetme duhej të ishte kualifikimi i grupit dhe jo sigurimi i fondeve. Meqenëse kryetari ka premtuar përkrahje, dhe ka deklaruar se do t'i përkrah vazhdimisht kërkojmë që ti përgjigjet kërkesës së klubit, data e nisjes së klubit për Sllovaki është me 15 Nëntor dhe realizimi i kërkesës shpresojmë që të bëhet sa më shpejt. Klubit i urojmë shumë fat! Kam edhe një kërkesë për drejtorin e Shëndetësisë meqenëse javën e kaluar është lansuar mamografi kishte me qenë mirë në një afat të caktuar të kryhet një mamografi falas për gratë e komunës që do i kishte inkurajuar gratë për vizita. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Liridona Lajçi Avdijaj.

Liridona Lajçi Avdijaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë më shumë e kam si kërkesë. A është e mundur ndonjë barnatore në Istog të qëndroj hapur 24 orë për shkak të shërbimeve të qytetarëve edhe gjatë natës. Është kërkesë prej disa qytetarëve. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Liridona! A ka edhe dikush pyetje? Po konsideroj që jo. Fjalën e ka kryetari I komunës.

Kryetari i komunës- faleminderit të gjithëve për pyetjet dhe interesimin! Po filloj me profesoreshën Ajshe. Sai perket çerdhës javën e kaluar ka pasur takim mes operatorit organit mbikëqyrës dhe ministrisë së Arsimit, është kontratë e nënshkruar mes ministrisë së Arsimit dhe operatorit, dhe me kërkesë pas konsultimeve të shumta dhe presionit në kuptimin e mirë të fjalës mes operatorit dhe mbikëqyrësit ata kanë arritur dakord me e bërë shkëputjen e kontratës dhe me e bërë prerjen e punimeve për shkak se kontrata është e nënshkruar më përpara për shkak se çmimet kanë pësuar ndryshime të jashtëzakonshme, dhe me e rishpallë si procedurë për pjesën e mbetur të punëve. Kjo punë ka dashur gati dy vite diskutime me u arritur, për shkak se duhet me i konsumuar mundësitë që i jep ligji i Prokurimit edhe operatorëve edhe autoriteteve kontraktuese. Floriana, dy herë komuna e Istogut e ka përkrahur në mënyrë direkte klubin e hendbollit, edhe njëherë i kam organizuar personalisht bashkë me akter që janë adhures të sportit përkrahje që nuk ka të bëjë me institucionin fare, në mënyrë që ai klub me i vazhduar sukseset që me u ndje krenarë të gjithë pa dallim politikë për të arriturat të cilat i ka. Jemi në fund të vitit, mundësitë për organizim ose për shpallje të thirrjeve të reja janë minimale ose me thënë fare. Është e pamundur që ne me i premtuar dikujt tani që mund të organizojmë thirrje publike që me i përkrahur klubet sportive në këtë fazë.

Premtimin që e kam dhënë e kam mbajtur tre herë jo vetëm një herë në raport me sukseset që i kanë treguar. Ju kisha rekomanduar si Lëvizje Vetëvendosje me e orientuar edhe në nivelin qendror sepse ministria e Kulturës i ka kapacitetet e mëdha të subvencionimit direkt edhe besoj klubi i hendbollit nuk është krenari vetëm për Istogun se janë gjashtë vajza që luajnë në kombëtaren e Kosovës. Dhe besoj që është obligim edhe nacional jo vetëm lokal. Liridonë për barnatoren kujdestare është formë e konsultës që po e bëjmë bashkë me drejtorinë e Inspektionit dhe Shëndetësisë në mënyrë që me e parë brenda për brenda rregullores komunale sa kemi të drejtë ti obligojmë bizneset private në mënyrë që ato me mbajtur barnatore kujdestare. E di që kemi pasur aktive gjatë kohës së pandemisë për shkak të gjendjes emergjente që ka ekzistuar, mirëpo në momentin që marrim interpretim edhe prej zyrës ligjore, në momentin e parë që gjejmë një vegzë ligjore një prej barnatorëve ka me qenë kujdestare nëpjesën e natës. Jemi në hulumtim e sipër po e shohim se çfarë rezultati po marrim. Agron, dhënia në shfrytëzim që i dhe theks parkingjeve, shkon përmes drejtorisë së Urbanizimit edhe Shërbimeve Publike, këto drejtori janë të ndërthurura mes vete që japin parkingje në shfrytëzim ose “hapësira publike” të cilat menaxhohen prej neve si komunë. Në bazë të rregullores komunale për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha, është procedurë e thjeshtë, vetëm duhet kërkesa dhe dalin pastaj zyrtarët që e vlerësojnë situatën në bazë të nevojës se a kanë me dhënë në shfrytëzim, po flas për pjesën e parkingjeve. Në dhënien në shfrytëzim të hapësirave që menaxhohen prej drejtorisë së Kulturës Rinise dhe Sportit, konkretisht Shtëpia e Kulturës, Palestra etj, ne e kemi pasur një thirrje publike në të cilën kanë aplikuar klubet OJQ-të pastaj për shkak të një ngërçi politik në raport me drejtorinë e Kulturës kemi ardhur deri këtu. Mirëpo javën e kaluar kemi pasur takim me drejtoreshën kemi biseduar dhe përmes ri aktivizimit të komisionit do t’i trajtojmë kërkesat që i kemi pranuar atëherë, një pjesë e të cilave është refuzuar, është dashur të themelohet komision për shqyrtimin e ankesave, tani me shqyrtimin e këtyre ankesave do dalim me vendime për dhënien në shfrytëzim të hapësirave dhe objekteve që janë në menaxhimin e drejtorisë së Kulturës. Se di a isha i qartë.

Agron Gashi- pikërisht për atë e bëra pyetjen, ato që shfrytëzohen edhe mbikëqyren nga drejtoria e Kulturës një ndër to është edhe parkingu i Palestrës, ajo bëhet si kërkesë për drejtorinë që e menaxhon atë sepse aty është duke u prishur ai vend, unë kam menduar që pasi e kemi rregulloren me e dhënë në shfrytëzim edhe paguan ai që e merr.

Kryetari i komunës- komplet parkingun po mendon?

Agron Gashi- po. Se e paguan e mirëmban edhe përfiton komuna se është duke u prishur. Faleminderit!

Kryetari i komunës- a është duke u prishur a jo është çështje prespektive, çështja e pazarit mendoj që është ngarkesë e tepruar për fermerët, me i obliguar me paguar taksa edhe për parking. Te pjesa e stines së verës po pajtohem, ndoshta kishte me qenë rentabile për komunën për shkak të fluksit të madh edhe të eskursioneve edhe mërgimtarëve, mirëpo gjithmonë me iden që me e shfaqur atë solidaritetin mikëpritës. Përndryshe në afërsi te pjesa ku gjindet objekti i shoqatës së gjuetarëve po planifikojmë me e filluar vitin e ardhshëm një objekt të përbashkët me kompaninë “Hidrodrini” edhe me kompaninë “Ambienti”, po mendoj pasi të mbyllet si cikël i infrastrukturës, e kemi me të lehtë si zonë me interes për dhënien në shfrytëzim në formë parkingu apo formë tjetër. Niman, i ke disa vite më pak se unë edhe do ishte dashur me pasur kujdes kur

shprehesh e sidomos kur del publikisht para qytetarëve të komunës së Istogut, sepse jam kryetar sepse më kanë votuar ata, dhe po të isha cilësuar ashtu siç me keni cilësuar ju, nuk besoj se do e kisha marrë atë përkrahje, përndryshe kur unë e vlerësoj që pyetjet kanë me marrë përgjigje direkte i jap, kur e vlerësoj që pyetjet kanë tentativë politike nuk i jap ose presin 30 e 60 e 90 ditë edhe mos me i jap fare. Do duhej që diskursi politik të na përfaqësonte edhe personalisht mos të mundohemi edhe me u tjetërsuar me fituar epitete ose poena se qytetarët e komunës së Istogut na dëgjojnë me vemendje dhe pastaj nuk kemi se çfarë çuditëmi nese marrim përkrahje. Unë nuk jam arrogant Niman, forma ime e punës nuk është me arrogancë por me qetësi. Rruga “Mehmet Ujupi” është momerandum i nënshkruar me ministrinë e Infrastrukturës konkretisht me z. Durmishi ato 18 shtëpi jo 30 kanë me e pasur rrugën nga mesi i vitit të ardhshëm. Është rrugë që ka rëndësi përtej banorëve sepse e lidh fshatin Kovragë e afron distancën me komunën e Istogut që ja u letëson pastaj edhe transportin e produktit bazë mollës që janë prodhuesi më madh në Republikë të Kosovës. Për policinë e shtrirë veç e dha përgjigjen drejtori, çështja e vendosjes së sferave të betonit ju Vrella ja dini punët më mire njëri tjetrit se çka ja u dimë ne edhe e di që ajo çështje është duke u trajtuar në Gjykatën Themelore dhe në momentin që ne marrim përgjigje ose vendim prej gjykate, reagimi ynë ka me qenë jashtëzakonisht i shpejt, qoftë me e liruar prej tyre qoftë me e liruar si hapësirë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj

Florin Dreshaj- desha vetëm dy fjalë me u ndërlidhur me çështjen që e ngriti kolegja Floriana, kryetari në një lloj mënyre i ngriti duart tha e kam trajtuar në një mënyrë special dhe nuk kemi më. Çështja është koxha serioze, nuk po dua as të marrë poena politk nëse doni mos e futni as në procesverbal, atyre ju duhen afërsisht 8000 euro. Në qoftë se nuk i kanë ato të holla ata nuk e kanë mundësinë me shkuar me marrë pjesë. Dhe në qoftë se dështojnë unë mendoj që dështon edhe komuna por edhe ministria përkatëse. Mendoj që do ishte dashur të munohet edhe kryetari me e bërë një zgjidhje edhe me ministry, që ata me e zhvilluar atë lojë sepse kur po fitojnë po ndihemi krenarë të gjithë jo vetëm ne po e gjithë Kosova. Z. Kryesues, a kemi edhe ne Kuvendi buxhet a diçka që mundemi me ju ndihmuar?

Kryesuesi i Kuvendit- Kuvendi nuk ka buxhet.

Florin Dreshaj- me e bërë një zgjidhje sepse çështja është shumë serioze. Edhe dënohen ata si klub nëse nuk marrin pjesë. Për shkak të 8000 eurove me dështuar, kishte me qenë marre edhe për komunën edhe për ministrinë. Po ushtrojnë, po japin kontibut, ndoshta kishim mundur edhe ne diçka si asambleistë me kontribuar me mbledh diçka që mos të dështon. Seriozisht po flas, rrogat i kemi pak më të mëdha, mundemi me bërë diçka.

Kryesuesi i Kuvendit

Falënderon të gjithë për durimin që patën, dhe kontributin e dhënë,
E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.
Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:15

**Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj**

**Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova**



Republika e Kosovës
Republika Kosova



Komuna e Istogut
Opstina Istok

00 Numër: /2023

Data: .11.2023

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT KOMUNAL NË ISTOG PËR VITIN 2024

Synimi

Me këtë Plan synohet që Kuvendi i Komunë të jetë sa më funksional në realizimin e kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin dhe aktet tjera nënligjore.

Objektivat

Kuvendi Komunal në Istog si organ përfaqësues dhe vendim-marrës i Komunës para së gjithash ka për objektiv ndërtimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit në mes Kuvendit dhe Ekzekutivit, qytetarëve dhe grupeve të interesit, organeve të pushtetit qendror dhe atë ndërkomunale, funksionimin sa më normal dhe efikas të Kuvendit sipas mandatit dhe përgjegjësi që ka, zhvillimin e demokracisë së brendshme, transparencës dhe kontrollit e mbi të gjitha respektimin dhe zbatimin e Kushtetutës dhe të gjitha ligjeve si derivat i saj si dhe miratimin dhe harmonizimin e të gjitha akteve normative Komunale me ligjet në fuqi me interes të përgjithshëm.

Qëllimi

Ky plan ka për qëllim informimin e drejtë dhe me kohë të të gjitha institucioneve komunale, organeve qendrore, qytetarëve, organizatave joqeveritare dhe çdo grupi të interesit lidhur me punën dhe aktivitetet e Kuvendit Komunal, komiteteve dhe trupave tjerë ndihmës të Kuvendit që mundëson realizimin e të drejtës të të gjitha grupeve të interesit të jenë akter serioz në vendimmarrje dhe të kenë ndikim në ngritjen të transparencës, përgjegjësisë, cilësisë dhe efikasitetit në punë të të gjitha organeve të Komunës.

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data
Janar	1. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2023. 2. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2023. 3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2023. 4. Shqyrtimi i raportit të punës së KKSBB-së për vitin 2023. 5. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	29.01. 2024	1. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2023. 2. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2023. 3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2023. 4. Raporti i punës së KKSBB-së për vitin 2023. 5. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	18.01. 2024	1. Raport mbi zbatimin e procesit të kthimit. 2. Shqyrtimi i raportit të punës së Komitetit për Komunitete gjatë viti 2023 3. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2022.	24.01. 2024

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data
Shkurt	Mbledhje Solemne e Kuvendit Komunal me rastin e 15 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për bartjen dhe shpërndarjen e mjeteve nga lista e projekteve kapitale nga viti fiskal 2023 në vitin 2024. 2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të NP. "Ambienti" për vitin 2023. 3. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	17.02. 2024 29.02. 2024	1. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për bartjen dhe shpërndarjen e mjeteve nga lista e projekteve kapitale nga viti fiskal 2023 në vitin 2024. 2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të NP. "Ambienti" për vitin 2023. 3. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	19.02. 2024	1. Raport mbi zbatimin e procesit të kthimit. 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Zhvillimor i DKA.	23.02. 2024

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa.	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data
Mars	1. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për vitin fiskal 2023. 2. Shqyrtimi i Raportit të punës së NK. "Stacioni i Autobusëve" për vitin 2023. 3. Shqyrtimi i Raportit të Planit të ofiçenses për vitin 2023. 4. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi.	28.03. 2024	1. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për vitin fiskal 2023. 2. Shqyrtimi i Raportit të punës së NK. "Stacioni i Autobusëve" për vitin 2023. 3. Shqyrtimi i Raportit të Planit të ofiçenses për vitin 2023. 4. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi.	19.03. 2024	1. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për vitin fiskal 2023. 2. Raport mbi zbatimin e procesit të kthimit.	25.03. 2024

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data
Prill	1. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar - Mars) të vitit 2024, 2. Njoftimi me kontratat e pronës së paluajtshme të komunës (Banesat, Objektet afariste dhe tokat bujqesore) 3. Njoftim me raportin për shfrytëzimin e pronave bujqësore të Komunës së Istogut. 4. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	29.04. 2024	1. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar - Mars) të vitit 2024, 2. Njoftimi me kontratat e pronës së paluajtshme të komunës (Banesat, Objektet afariste), 3. Njoftim me raportin për shfrytëzimin e pronave bujqësore të Komunës së Istogut. 3. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	18.04. 2024	1. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar - Mars) të vitit 2024, 2. Raport mbi zbatimin e procesit të kthimit. 3. Shqyrtimi i raportit për punën e Zyrës për Komunitete për vitin 2023.	24.04. 2024

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data
Maj	1. Njoftimi me Qarkoren Buxhetore nr.1 të Ministrisë së Financave për kufijtë preliminar të përgatitjes së Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027 2. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	29.05. 2024	1. Njoftimi me Qarkoren Buxhetore nr.1 të Ministrisë së Financave për kufijtë preliminar të përgatitjes së Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027 2. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	20.05. 2024	1. Njoftimi me Qarkoren Buxhetore nr.1 të Ministrisë së Financave për kufijtë preliminar të përgatitjes së Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027 2. Raport mbi zbatimin e procesit të kthimit. 3. Shqyrtimi i raportit për punën e Zyrës për Komunitete për vitin 2024.	24.05. 2024

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data
Qersh or	Mbledhja solemne e K.K. për nder të ditës së çlirimit të Istogut 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027, 2. Njoftimi me Raportin vjetor të punës së prokurimit për vitin 2023. 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për rishikimin e buxhetit. 4.Marrja e Vendimit për vizitë studimore jashtë vendit,(shkëmbim përvojash) 5. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	20.06 2024 27. 06 2024	1. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2026, 2. Njoftimi me Raportin vjetor të punës së prokurimit për vitin 2023. 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për rishikimin e buxhetit. 4.Marrja e Vendimit për vizitë studimore jashtë vendit,(shkëmbim përvojash) 5. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	18. 06. 2024	1. Raporti mbi realizimin e procesit të kthimit. 2. Shqyrtimi i Raportit të punës i Zyrës për Komunitete për vitin 2024. 3. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023. 6. Shqyrtimi i Planit Zhvillimor të Drejtorisë së Arsimit 7. Veprimtaritë në terren	25. 06. 2024

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data
Korrik	1. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2024. 2. Njoftimi me raportin e punës së Kryetarit të komunës për 6 mujorë të vitit 2024, 3. Njoftimi me raportin e Përformances për vitin 2023. 4. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesat nga ekzekutivi	29 .07. 2024	1. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2024. 2. Njoftimi me raportin e punës së Kryetarit të komunës për 6 mujorë të vitit 2024, 3. Njoftimi me raportin e Përformances për vitin 2023. 4. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesat nga ekzekutivi	19.07. 2024	1. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2022. 2. Shqyrtimi i raportit për punën e Zyrës për Komunitete për vitin 2022. 3. Shqyrtimi i raportit financiar për tremujorin e dytë të vitit fiskal 2024 4. Njoftimi me raportin e punës së Kryetarit të komunës për 6 mujorë të vitit 2024, 5. Shqyrtimi i projektvendimeve dhe kërkesave të ekzekutivit	25.07. 2024

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data
Gusht	Pushim	Pushim	Pushim	Pushim	Pushim	Pushim
Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data
Shtator	Dëgjimi publik i Draft Buxhetit Komunal për vitin 2025-2027. 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2025-2027 2. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe Planit të Veprimit për Eliminimin e të metave të rekomanduara nga AP. 3. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Brendshëm për vitin 2023 dhe Planit të veprimit. 4. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	__ .09. 2024 27.09. 2024	1. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2023-2026. 2. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe Planit të veprimit për eliminimin e të metave të rekomanduara nga AP. 3. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Brendshëm për vitin 2023 dhe Planit të veprimit. 4. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	18.09. 2024	1. Raport mbi zbatimin e procesit të kthimit 2. Shqyrtimi i Raportit të punës së Zyrës për Komunitete për 6 mujorin e parë të vitit fiskal 2024. 3. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Brendshëm për vitin 2023 dhe Planit të Veprimit. 4. Shqyrtimi i projektvendimeve dhe kërkesave të ekzekutivit	24 .09. 2024

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data
Tetor	1. Shqyrtimi i raportit financiar për 3 mujorin e tretë (korrik-shtator)të vitit fiskal 2024. 2. Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025. 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Eficiencë dhe Klimë për K. Istog, 4. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	29.10. 2024	1. Shqyrtimi i raportit financiar për 3 mujorin e tretë (korrik-shtator)të vitit fiskal 2024. 2. Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025. 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Eficiencë dhe Klimë për K. Istog, 4. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	17.10. 2024	1. Raport mbi zbatimin e procesit të kthimit 2. Shqyrtimi i Raportit të punës së Zyrës për Komunitete për vitin 2024. 3. Shqyrtimi i raportit financiar për 3 mujorin e tretë (korrik-shtator)të vitit fiskal 2024. 4. Rishikimi i Planit të Veprimit për Eficiencë të Energjisë dhe Klimës për Komunën e Istogut, 5. Shqyrtimi i projektvendimeve dhe kërkesave të ekzekutivit.	24.10. 2024

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data
Nëntor	1. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft- Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025. 2. Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha. 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për caktimin e normave për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025. 4. Njoftimi me raportin e punës së Komiteteve Konsultative. (drejtori i Drejtorisë) 5. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	28.11.2024	1. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft- Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025. 2. Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha. 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për caktimin e normave për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025. 4. Njoftimi me raportin e punës së Komiteteve Konsultative. (drejtori i Drejtorisë) 5. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	19.11.2024	1. Raport mbi zbatimin e procesit të kthimit 2. Shqyrtimi i raportit të zyrës për komunitete për vitin 2024. 3. Shqyrtimi i Projekt Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025. 4. Shqyrtimi i projektvendimeve dhe kërkesave të ekzekutivit. 5. Shqyrtimi i Draft Planit Vjetor të Punës së Komisionit për Komunitete për vitin 2025.	25.11.2024

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data
Dhjetor	1. Njoftimi me Planit vjetor të punës së Zyrës së Prokurimit. 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës KKSb. 3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Planit të Integritetit për vitin 2023, 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për taksa Ngarkesa dhe Gjoha.	26.12. 2024	1. Njoftimi me Planit vjetor të punës së Zyrës së Prokurimit. 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës KKSb. 3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Planit të Integritetit për vitin 2023, 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për taksa Ngarkesa dhe Gjoha.	17.12. 2024	1. Raport mbi zbatimin e procesit të kthimit 2. Shqyrtimi i raportit të zyrës për komunitete për vitin 2024. 3. Shqyrtimi i raportit për punën e Zyrës për Komunitete për 6 muajt e tjerë të vitit fiskal 2024. 4. Shqyrtimi i Projekt rregullores për Tatimet,Taksat dhe Gjobat	20.12. 2024

Sqarim:

Grupi punues për hartimin e Planit vjetor për punën e Kuvendit Komunal me kujdes dhe përgjegjësi ka shqyrtuar të gjitha ligjet dhe aktet tjera nënligjore të nivelit qendror e të cilat kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe kompetencat ligjore të Kuvendit Komunal dhe kryetarit të Komunës dhe me përpikëri dhe përkushtimin më të madh i ka përfshirë në këtë planë si aktivitete me qëllim që kuvendi të jetë sa më funksional dhe përgjegjës në realizimin e kërkesave të qytetarëve ,anëtarëve të Kuvendit ,KPF-së, KK, dhe të kërkesave dhe përgjegjësi të kryetarit të Komunës. Mirëpo, sigurisht që dinamika e këtij plani gjatë zbatimit mund të pësoj ndryshime dhe plotësime sipas nevojës dhe paraqitjes së kërkesave të arsyeshme qoftë nga ana e qytetarëve, delegatëve të Kuvendit dhe kryetarit të Komunës apo edhe përgjegjësi të tjera që dalin nga miratimi ligjeve të reja dhe akteve tjera nënligjore.

Anëtarët e Komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024:

1. Enver Rugova, Kryesuesi i Kuvendit Komunal;
2. Arben Kabashi, Drejtor i Administratës;
3. Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lartë për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës;
4. Arta Balaj, anëtare e Kuvendit nga LDK;
5. Negjdet Ramaj, anëtar i Kuvendit nga AAK;
6. Florin Dreshaj, anëtar i Kuvendit nga LVV;
7. Andi Xhuraj, anëtare e Kuvendit nga PDK;
8. Melis Smakic, anëtar i Kuvendit nga GIBI;
9. Rexhë Mulaj, anëtar nga shoqëria civile.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova



Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo



Komuna e Istogut

Opshtina Istok

Municipality of Istog

00 Numër: /2023

: <http://kk.rks-gov.net/istog/>

Data:

Rregullore Komunale Nr. /2023

KUVENDI I KOMUNËS

Projekt:

**RREGULLORE PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E RREGULLORËS
KOMUNALE PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA**

Tetor/2023

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 12.2 pika c) dhe nenit 40 paragrafit 40.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27/2008), dhe bazuar nën 33 paragrafi 1 dhe 6 dhe neni 34 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Istogut 01nr.62/2010, në mbledhjen e mbajtur me datë: 2023 miratoi këtë:

RREGULLORE
KOMUNALE PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen të gjitha të hyrat komunale duke përfshirë taksat, ngarkesat dhe gjobat të cilat do të arkëtohen nga Drejtoritë Komunale bazuar në Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Neni 2
Drejtoria për Administratë

Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve	Shuma në €
1. Regjistrimi në Gjendjen Civile	
1.1. Kompletimi i dosjes së aplikimit për lirim dhe fitim të shtetësisë;	20
1.2. Lidhja e martesës jashtë institucionit dhe jashtë orarit të punës;	50
1.3. Lidhja e martesës jashtë orarit të punës brenda institucionit;	15
1.4. Lidhja e martesës dhe regjistrimi i martesës në “Regjistrin e Martesës” me procesverbal;	5
1.5. Lidhja e martesës me shtetasin e huaj dhe regjistrimi i martesës në “Regjistrin e Martesës” me procesverbal;	30
1.6. Marrja e Aktvendimit për ndryshimin e emrit personal dhe regjistrimi në “Regjistrin e Lindjes” dhe “Regjistrin e Martesës”;	30
1.7. Përmirësimi i gërmëzimit të emrit personal;	3
1.8. Anulimi i regjistrimit të lindjeve në dy komuna;	10
2. Lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile	
2.1. Ekstrakti i lindjes nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile brenda vendit;	1
2.2. Ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile që shërben brenda dhe jashtë vendit;	2
2.3. Certifikata e lindjes brenda vendit;	1
2.4. Certifikata e lindjes që shërben brenda dhe jashtë vendit;	2
2.5. Certifikata e martesës brenda vendit;	1
2.6. Certifikata e martesës që shërben brenda dhe jashtë vendit;	2
2.7. Certifikata e vdekjes brenda vendit;	1
2.8. Certifikata e vdekjes që shërben brenda dhe jashtë vendit;	2

2.9. Certifikatë e Statusit Martesorë brenda vendit;	1
2.10. Certifikatë e Statusit Martesorë që shërben brenda dhe jashtë vendit;	2
2.11. Certifikata e vendbanimit brenda vendit;	1
2.12. Certifikata e vendbanimit që shërben brenda dhe jashtë vendit;	2
2.13. Certifikata e shtetësisë brenda vendit ;	1
2.14. Certifikata e shtetësisë që shërben brenda dhe jashtë vendit;	2
3. Vërtetimet e gjendjes civile	
3.1. Vërtetimi mbi konfirmimin e emrit personal;	5
3.2. Vërtetimi mbi mjetet për jetesë;	5
3.3. Vërtetimi i nënshkrimit përshkrimit dhe dorëshkrimit;	2
3.4. Vërtetime të ndryshme;	5
3.5. Njohja e vendimit nga shteti i huaj për ndryshim të emrit;	10
3.6. Vërtetimi nga arkiva,	1
3.7. Vërtetimi për ndërrimin e vendbanimit;	1
3.8. Formular për shtesa të fëmijëve jashtë vendit;	1
4. Vërtetimi i deklaratave	
4.1. Deklarata për bashkësinë familjare sipas UA Nr.24/2015;	2
4.2. Deklarata e bashkësisë familjare që shërben brenda dhe jashtë vendit;	2
4.3. Deklaratë e gjendjes personale të personit fizik;	2
4.5. Dëshmi mbi vdekjen dhe përshkrimin e pasurisë (Aktvdekja);	2
5. Përpilimi dhe parashtrimi i shkresave-kërkesave	
5.1. Parashtrimi i kërkesave të ndryshme drejtuar organeve komunale;	1

Neni 3
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

1. Dhënia e aktit për kushte tekniko-urbanistike për zonat që nuk kanë plan rregullues urban	Shuma në €
1.1. Për parcelimin e parcelës;	30
1.2. Muret rrethuese;	10
1.3. Për objekte të përkohshme-afariste;	20
1.4. Për objekte ndihmëse;	2
1.5. Për garazhe;	15
1.6. Kërkesa për shfrytëzimin të dokumentacionit të shërbimeve Pronësores-Juridike për banesa;	5
1.7. Për vazhdimin e Lejes për ndërtim dhe lëshimi Lejes Ndërtimore duplikat;	30
1.8. Vërtetime dhe pëlqime të ndryshme;	10
2. Taksat për leje ndërtimi	
2.1. Taksa Administrative për leje ndërtimore, për kategorinë I;	1.52 € m ²
2.2. Taksa Administrative për leje ndërtimore, për kategorinë II;	2.37 € m ²

2.3. Tarifa rregullative për densitetin të infrastrukturës për objekte për banim (m ² /50)*149.59 p.sh. (100/50)*149.59=299.18€ /100	2.99 € m ²
3. Lëshimi i Lejes Komunale Mjedisore sipas Udhëzimi Administrativ Nr.01/2017	
3.1. Tarifat në vlerën investive të projektit deri 25,000 euro	50
3.2. Tarifat në vlerën investive të projektit mbi 25,000 euro	0.2% të vlerës investive
3.3. Lëshuarja e vendimit për leje përdorimi për objekt individual shtëpi banimi;	30
3.4. Lëshuarja e vendimit për leje përdorimi për objekt shumë banesore për çdo banesë;	20
3.5. Lëshuarja e certifikatës së përdorimit për lokale afariste brenda objektit shumë banesor;	20
3.6. Lëshuarja e certifikatës së përdorimit për lokale afariste individuale;	30
3.7. Lëshuarja e certifikatës së përdorimit për lokale objekte industriale.	100
3.8. Lëshuarja e certifikatës së përdorimit për hotele, motele dhe restorante.	80
4. Leje tjera	
4.1. Leje për vendosjen e foltoreve telefonike;	10
3.2. Leje për shtrirjen e rrjetit kabllor (ajror) të internetit për metër gjatësi;	0.05
3.3. Leje për shtrirjen e rrjetit elektrik (ajror) për metër gjatësi;	0.03
3.4. Leje për vendosje e ormanëve shpërndarëse MDF për copë;	15
3.5. Leje për ndërtimin-vendosjen e trafave elektrike;	20
3.6. Leje për vendosjen e antenave;	20
3.7. Leje për përçoja nëntokësore: kanalizim, ujësjellës, rrjet kabllor elektrikë, rrjetë kabllor të internetit për metër gjatësi;	0.06
3.8. Leje për rrënim për m ² ;	1
4. Kompensimi për tokën ndërtimore në zonat urbane të cilën Komuna e ka dhënë në shfrytëzim të përkohshëm paguhet për një muaj	
4.1. Sipërfaqja prej 1-10 m ² ;	5
4.2. Sipërfaqja prej 11-30 m ² ;	4
4.3. Sipërfaqja prej 31-50 m ² ;	3
4.4. Sipërfaqja mbi 51 m ² ;	2.5
5. Taksat për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike përkohësisht prej 0-1 vit	
5.1. Vendosja e tezgave lëvizëse dhe objekteve tjera të vogla të përkohshme–sezonale, në të cilat kryhet veprimtaria tregti, reklamim malli për shfrytëzim një ditë;	10
5.2. Vendosja e tezgave lëvizëse dhe objekteve tjera të vogla të përkohshme–sezonale, në të cilat kryhet veprimtaria tregti, reklamim malli e të tjera shfrytëzimi një javor;	15
5.3. Vendosja e tezgave lëvizëse dhe objekteve tjera të vogla të përkohshme–sezonale, në të cilat kryhet veprimtaria tregti, reklamim malli e të tjera shfrytëzimi një muaj;	20
5.4. Leje për vendosjen e tavolinave para lokaleve hoteliereve për m ² –mujore;	2
6. Vendosja e pllakateve reklamuese në hapësira publike tarifa (mujore) për m²	
6.1. Pllakatet;	5
6.2. Pllakatet reklamuese me ndriçim;	6
6.3. Vendosja e reklamave elektronike reklamuese;	9
6.4. Vendosja e reklamave në muret e ndërtesave publike;	6
6.5. Vendosja e banereve-mujore;	20

7. Ngarkesat për organizimin e lodrave argëtuese dhe lojërave argëtuese automatike të ndryshme.	
7.1. Vendosja e aparateve për lojëra argëtuese, ngarkesa mujore për çdo aparat sipas llojit;	20
7.2. Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e objekteve argëtuese parqe, sheshe tarifë mujore për m ² ;	0.50
8. Shërbime tjera	
8.1. Shfrytëzimi i hapësirave të ndërtesave në pronësi të komunës për m ² në muaj;	1.5
9. Taksa për trajtimin të ndërtimeve pa leje (Ligji NR. 08/L-184 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit NR. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje)	
9.1. Taksa për legalizim të ndërtimeve pa leje të kategorisë I për m ²	1
9.2. Taksa për legalizim të ndërtimeve pa leje të kategorisë II për m ² ;	2
9.3. Ndërhyrjet në ndërtimet me leje për m ² ;	2
10. Taksa për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore sipas Planit Zhvillimor Komunal 2019-2027 (Udhëzimi Administrativ Nr.41/2006)	
10.1. Kategoria e parë (Kalsa I deri IV) për m ² ;	1
10.2. Kategoria e dytë (Kalsa V deri VI) për m ² ;	0.75
10.3. Kategoria e tretë (Kalsa VII deri VIII) për m ² ;	0.50

Neni 4
Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi

Tarifat e shërbimeve dhe produkteve kadastrale rregullohen sipas:	
1. Udhëzimit Administrativ MMPH- Nr. 11/19 për Ndarjen e Ndërtesës dhe të Pjesës së Ndërtesës	
2. Udhëzimi Administrativ MMPH- Nr. 12/19 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës	
3. Udhëzimi Administrativ MEA- Nr. 09/2020 për Tarifat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme.	

Neni 5
Drejtoria për Buxhet e Financa

Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve	Shuma në €
1. Dhënia e certifikatave	
1.1. Dhënia e Certifikatave mbi gjendjen ekonomike;	2
2. Taksa për Automjetet Motorike	
2.1. Për automjetet që peshon deri në 3.5 ton;	15
2.2. Për automjete mbi 3.5 ton;	30

Neni 6
Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim

Emërtimi dhe përshkrimi dokumenteve	
1. Taksa për pagesë për pune jashtë orarit të rregullt	
1.1. Taksa për një ore pune të veprimtarive tregtare;	5
1.2. Taksa për një ore pune të veprimtarive hoteliere;	10
1.3. Taksa për një ore pune të veprimtarive zejtare;	5
1.4. Taksa për një ore pune të veprimtarive shërbyese;	10

Neni 7
Drejtoria për Arsim

Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve		Shuma në €
1. Participimet për vijim të fëmijëve në kopshte		
1.1. Participimi në baza mujore për kopshtin e fëmijëve në Istog,		30
1.2. Participimi në baza mujore për kopshtin e fëmijëve në Gurrakoc dhe Banjë;		25
1.3. Participimi në baza mujore për kopshtin e fëmijëve në Vrellë dhe Rakosh.		20
2. Participim për mësimin joformal		
2.1. Për regjistrimin e vitit;		100
2.2. Për vijimin e mësimi praktik;		50
2.3. Për provimet përfundimtare të klasave-certifikatë;		30
2.4. Për diplomë të përfundimit të shkollimit;		20
2.5. Provimi diferencial		10
3. Pagesat për dokumente shkollore		
3.1. Pagesa për nxjerrjen e diplomës duplikat;		1
3.2. Pagesa për nxjerrjen e dëftesës duplikat;		1
3.3. Certifikata për kryerjen e ciklit fillor 1–5 duplikat;		1
3.4. Certifikata për kryerjen e nivelit 6–9 duplikat;		1
3.5. Certifikata për kryerjen e arsimit të obliguar duke i përfshirë dy nivelet 1–9 duplikat;		1
3.6. Vërtetimet e ndryshme të cilat i kërkojnë ish nxënësit (palët) si në arsimin e obliguar ashtu edhe në arsimin e mesëm të lartë;		0
3.7. Për dëftesat e lëshuara kandidatëve që kanë të kryer shkollimin e obliguar sipas sistemi të vjetër të arsimit.		1

Neni 8
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

1. Shfrytëzimi i hapësirës në Shtëpinë e Kulturës “Adem Jashari”		
1.1. Salla e madhe e koncerteve për një mbrëmje;		200
1.2. Holli për mbrëmje rinore (një natë);		50
1.3. Salla e gjelbër (për një ditë);		10
1.4. Anëtarësimi në bibliotekë për nxënës deri në klasën e nëntë;		2
1.5. Anëtarësimi në bibliotekë për të gjithë të tjerët;		3
